

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1227 Prot.

Tiranë, më 05.122016

VENDIM Nr. 130, datë 22.11.2016

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 13 të datës 22.11.2016, pasi shqyrtoi Relacionin mbi verifikimin e punimeve për "*Sistemimin e kanalizimeve të ujërave të zeza të qytetit të Elbasanit*", realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

VENDOSI:

1. Të kryhet nga subjekti ndërtues "Victoria Invest" sh.p.k. spostimi i kanalit të ujërave të zeza, në anë të profilit të rrugës "Rinia", duke shmangur murin e hendekut të periudhës romake të Kalasë së Elbasanit, për segmentin e kësaj rruge, që kufizohet me zonën arkeologjike "A" të këtij qyteti.
2. Të realizohet nga ASHA një sondazh arkeologjik me përmasa 10m x 3m, pranë zonës së kullës lindore të Kalasë së Elbasanit, për të sqaruar situatën dhe për të paraprirë në kohë dëmtimeve të mundëshme të hendekut të periudhës romake.
3. Investitori për kryerjen e sondazhit arkeologjik në zonën e sipërpërmendur, duhet të lidhë më parë akt-marrëveshje dy palëshe me Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të realizojë atë. Raporti i tij do të paraqitet në KKA e radhës.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për sondazhin e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës dy palëshe.
5. Të kryhet monitorimi i punimeve të zbatimit për segmentin e rrugës së sipërpërmendur, nga DRKK Durrës, duke bashkërenduar veprimtarinë dhe informacionin me ASHA, e cila do të kryejë sondazhin në këtë zonë.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTRE



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO